

PKR.nr.672/13

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,** si gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët Suzana Çerkini kryetare, Arben Hoti dhe Shpresa Hyseni -Haskaj anëtarë, me sekretaren juridike Albulena Ademi, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.M. nga G., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK, i akuzuar me Aktakuzë të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.116-5/2010 të datës 09.10.2012, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, të hapur për publikun të mbajtur me datë 07.05.2018 me praninë e Prokurorit të shtetit Ilaq Beqiri, të akuzuarit L.M., me mbrojtësin sipas autorizimit av.Z.J., si dhe të dëmtuarin dëshmitarin M.Zh. me datë 07.05.2018 mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari L.M.**, i biri i Z.1 dhe nënës Z.2 e vajzërisë N., i lindur me ... në P..., tani me vendbanim në fshatin G., ka të kryer shkollën e mesme, student, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Serb – shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal ...,

Në bazë të nenit 364 par.1 nënpar. 1.3 të KPP,

**LIROHET NGA AKTAKUZA**

**Sepse**, me datë 09.01.2010, rreth orës 15:45 në G., me pushkën ajrore e tipit Meteor SSM, me numër serik A162001 të cilën e kishte marr i pandehuri S.M., e kishte përdorur në mënyrë të paautorizuar dhe kishte shkrepur me të, me ç'rast e kishte vrarë një pëllumb, pronë e të dëmtuarit M.Zh. dhe më pas me pushkën ajrore të lartpërmendur me 7 (shtatë) fishek ia ka kthyer të pandehurit Sllavisha Mikiq po të njëjtën ditë,

- Pasi që nuk është provuar se ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK,
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës,
- I dëmtuari M.Zh.nga G. është udhëzuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridiek në kontest të rregullt juridiko-civil,

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda me Aktkuzën PP.nr.116-5/2010 të datës 09.10.2012, ka akuzuar Slavisa Mikic nga Graçanica për veprë penale Mbajtja në pronësi, posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK,

L.M. nga G. për vepër penale Mbajtja në pronësi, posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK, dhe Z.M. e M.M. të dy nga G. për veprën penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 316 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të njëjtit t'i shpall fajtor dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar, jashtë seancës gjyqësore fillimisht me aktvendim të veçantë PKR.nr.672/13 të datës 16.03.2018 ka Hudhë pjesërisht aktakuzën PP.nr.116-5/2010 të datës 09.10.2012 sa i përket të akuzuarit S.M. për shkak se vepra penale Mbajtja në pronësi, posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK sipas nenit 1 dhe 3 par.1 nënëpar.1.2 pika 1.2.5 të Ligjit për Amnisti (në fuqi nga data 04.10.2013) është aministuar, ndërsa të akuzuarit Z.M. dhe M.M. për vepër penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 316 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK, duke pasë parasysh kohën e kryerjes së veprës penale me datë 09.01.2010, është konstatuar se me datë 09.01.2016 është arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Rrjedhimisht, gjykata ka proceduar çështjen penale vetëm me të akuzuarin L.M. i akuzuar për vepër penale Mbajtja në pronësi, posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK, për të cilën vepër i akuzuari në prani të mbrojtjesit të tij të autorizuar av. Z.J., nga fillimi e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka mohuar fajsinë, ndërsa mbrojtësi i tij në fjalën përfundimtare deklaroi se me provat e administruara nuk mund të pranohet e as të dyshohet se i mbrojturi i tij L.M. në ditën kritike ka vepruar siç ceket në aktakuzë, nga vetë deklarata e të dëmtuarit dëshmitarit kur e pyesin a e ke pa ti kush ta ka mbytur pëllumbin, përgjigjet që nuk e ka parë, andaj me asnjë provë dhe fakt nuk është vërtetuar që i mbrojturi i tij ka kryer këtë vepër penale, përdorimi i pushkës ajrore dhe gjatë kryerjes së saj është mbytur pëllumbi, andaj i propozoi gjykatës që në mungesë të provave të mbrojturin e tij t'a lirojë nga akuza. Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë aktakuzës duke theksuar se nga deklarata e të dëmtuarit u vërtetua se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit njëherësh të dëmtuarit t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar.

Meqenëse i akuzuari nuk e pranoi fajsinë, gjykata ka vazhduar procedimin e çështjes me administrimin e provave. Në shqyrtim gjyqësor gjykata ka dëgjuar të dëmtuarin M.Zh.dhe nga deklarata e tij vërtetoi se i njëjti nuk e kishte parë fare pëllumbin e mbytur e as nuk e kishte parë me sy të akuzuarin L. me armë në dorë apo duke e gjuajtur pëllumbin e tij, por vetëm kishte parë kur pëllumbi kishte rënë mbi kulmin e fqiut andaj edhe kishte dërguar një fqinjë tjetër për të pyetur tek i akuzuari L. se çfarë i ndodhi pëllumbit për çka edhe e kishte lajmëruar rastin në polici. I dëmtuari thekson se më herët asnjëherë nuk ka pasur probleme me fqinjët e madje as me familjen e L., kurse për pëllumbin ndihet i dëmtuar sepse që nga fëmijëria mbanë pëllumba, edhe sot vazhdon të mbajë.

Ndërsa i akuzuari L.M. në mbrojtjen e tij deklaroi se pushka me të cilën është mbytur pëllumbi i fqinjit nuk është e tij, ajo pushkë ka qenë e fqinjit tjetër S.M. tek i cili edhe është gjetur pushka e jo në shtëpinë e tij. Pra, i akuzuari L.M. asesi nuk pranon se ditën kritike të ketë gjuajtur pëllumbin meqë edhe shtëpitë me të dëmtuarin i kanë në largësi diku 300 m afërsisht, pohon se me M. nuk flasin më shumë se 12 vjet ndoshta edhe më shumë, për shkak të një mosmarrëveshje sepse djali i tij e kishte goditur dhe, shton se kur policia kishte shkuar tek ai për bastisje pushka kishte qenë veq tek fqinji, tek pronari i pushkës, ndërsa në oborrin e tij nuk kishin gjetur asgjë e as gëzhgjë, apo armë tjetër.

Gjykata, nuk i vlerësoi provat tjera si, lista e provave materiale dhe raporti i policit S.B. nga vendi i ngjarjes, meqë të njëjtat nuk ishin relevante për veprën penale për të cilën akuzohet L.M., por për veprat tjera me të cilat fillimisht ishin akuzuar personat tjerë ndaj të cilëve tanimë ishte hudhur aktakuza, ndërsa në shqyrtim gjyqësor prokurori i shetit hoqi dorë nga propozimi për dëgjimin e dëshmitarit policit S.B. meqë dëshmia e tij nuk kishte të bëjë me objektin e akuzës sa i përket të akuzuarit L.M..

Andaj gjakata, pas administrimit të provave të disponueshme në shqyrtim gjyqësor dhe dëgjimit të t'akuzuarit L.M., bëri vlerësimin e tyre një nga një dhe të ndërlidhura reciprokisht njëri me tjetrin konform nenit 361 të KPP dhe, vërtetoi se gjendja faktike nuk përputhet me gjendjen e përshkruar si në aktakuzë, përkatësisht mungojnë provat me të cilat do të vërtetohej fajsia e të akuzuarit L.M., përkatësisht nuk vërtetoi se i akuzuari L.M. me datë 09.01.2010 ka përdorur armën e lartshënuar me të cilën armë e ka vrarë pëllumbin e të dëmtuarit. Ndërsa në shkresa të lëndës nuk ekziston dëshmia se nga i akuzuari është konfiskuar arma e precizuar si në aktakuzë, meqë gjatë bastisjes arma nuk ishte gjetur në shtëpinë e të akuzuarit L.M.. Andaj duke pas parasysh situatën me dilemë për vendosjen e çështjes, gjykata pati parasysh dhe aplikoi parimin **In dubio pro reo**, sipas të cilit Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të akuzuarve dhe të drejtave të tyre.

Rrjedhimisht gjykata nuk ka vërtetuar se janë përmbushur elementet qenësore të veprës penale të Mbajtjes, posedimit, kontroll dhe shfrytëzimit të paautorizuar të armeve nga neni 328 par.1 të KPK, andaj, mbi bazën e të lartcekurave vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregulltë juridiko civil për të dëmtuarin M.Z., gjykata e mori në bazë të nenit 463 par. 3 të KPP.

Vendimin mbi mbi lirimin në tërësi nga shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 454 par.1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.672/13, me datë 07.05.2018**

**Sekretarja juridike,  
Albulena Ademi**

**Kryetarja e trupit gjykues,  
Suzana Çerkini**

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.